

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR B MARINE SH.P.K.,

Në Sarandë, sot në datën 05.07.2022, unë ortaku i vetëm EDVIN BIXHA, shtetas shqiptar, identifikuar me nr. ID 036950672 Dhe nr. Personal I90316092B banues në Fier, Shqipëri, për bazë dhe në mbështetje të ligjit nr. 9901., datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **B Marine sh.p.k.**

Neni 1 Emri dhe lloji

Eshtë themeluar shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **B Marine sh.p.k.**, e cila është një **Agjensi e Shërbimeve Detare** dhe gëzon statusin e personit juridik. Kjo shoqëri do të nënshtrohet legjislacionit shqipëtar si dhe do të zhvillojë veprimtarinë e saj tregtare në bazë të legjislacionit tregtar në fuqi, aktit të themelimit si dhe statutit të saj, i cili do të miratohet nga ortaku themelues.

Neni 2 Selia

Selia e shoqërisë do të jetë në Sarandë. Adresa e selisë është: "Lagjia nr.4; Rruga Mit'hat Hoxha; Porti detar, Sarandë.

Sipas rastit shoqëria do të hapë seli sekondare, degë, filial, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 3 Qëllimi dhe fusha e veprimtarisë

Duke përfshirë por, pa u kufizuar, **B Marine sh.p.k.**, si një **Agjensi e Shërbimeve Detare** do të ushtrojë veprimtari në:

1. Ofrimin e shërbimeve të furnizimit me produkte (të ndryshme) dhe klasa të ndryshme karburanti për mjete lundruese detare si jahte (AGO / ULSD dhe LSMGO / MGO), anije etj. Shoqëria do të punojë drejtpërsëdrejti me klientët duke përfshirë kompanitë e menaxhimit të jahteve, Kapitenë & Inxhinierët, tregtarët dhe agjentët e jahteve.
2. B Marine sh.p.k., fillimisht do të ushtrojë aktivitetin në territorin dhe portet detare të Republikës së Shqipërisë si pjesë e strategjisë afatshkurtër të saj dhe në kuadrin e një strategjie afatgjatë synon tërheqjen dhe fitimin e klientëve të mëtejshëm si dhe hytjen e zgjerimin e saj në tregje të veçanta duke synuar rritjen e saj në portet e rajonit dhe më gjerë.
3. Ofrimin e shërbimeve teknike për mjete lundruese detare, pastrime për jahtet dhe anije të tjera si dhe shërbime të tjera të nevojshme për këto të fundit (riparime, menaxhimi & mirëmbajtja, ruajtja dhe dimërimi, zëvendësimi antifouling dhe sakrifikues i anodes, shërbimet e tekstilit me fije qelqi dhe shërbime karpenterie të anijeve etj.)
4. Ofrimin e shërbimeve dhe furnizimit të bordit.
5. Rezervime për jahtet, organizime udhëtimesh, qiradhënie të mjeteve, planifikime itinerarësh, asistencë dhe shërbime mbi formalitetet doganore dhe ato të emigracionit.
6. Shërbime dhe aktivitete që përfshijnë zhytje, diving, eksplorime nënujore (sipas legjislacionit në fuqi duke përfshirë edhe autorizimin, marrjen e licensave përkatëse si dhe kryerjen e kualifikimeve të nevojshme).
7. Çdo veprimtari tjetër, e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me këto veprimtari, dhe që mund të mos jetë përmendur specifikisht në objekt, por, as nuk është

ndaluar si në këtë akt themelimi ashtu edhe nga legjislacionet në fuqi, të cilat shihen se janë të dobishme dhe të nevojshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e shoqërisë.

Neni 4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkak. Ajo mund të ndryshojë emrin, selinë, objektin e veprimtarisë dhe kohëzgjatjen e saj si dhe çdo gjë tjetër me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10000 lekë. Ky kapital ndahet në: 1 (një) kuotë me vlerë nominale 10000 lekë, e ndërvarur nga ortaku i vetëm. Ky kapital mund të shtohet sipas vendimeve të shoqërisë dhe do të depozitohet në një nga bankat e nivleit të dytë në Sarandë. Kuota mund ti transferohet të tretëve sipas parashikimeve në Statut ose në legjislacionin në fuqi.

Neni 6 Administratori

Shoqëria do të drejtohet nga administrator i saj, z. Edvin Bixha, i cili emërohet në këtë detyrë për një afat prej 2 vjetësh, të drejtat dhe detyrat e të cilit do të përcaktohen në Statut. Për ndjekjen e procedurave të nevojshme për regjistrimin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe përfaqësimin me të tretët ngarkohet administratori dhe ortaku i vetëm i saj.

Neni 7 Të ardhurat e shoqërisë

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm themelues. Për detyrimet që shoqëria do të krijojë ndaj të tretëve përgjigjet me pasurinë dhe kapitalin e saj. Ortaku nuk mban përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasurinë e tij që nuk është pjesë e kapitalit të kësaj shoqërie.

Neni 8 Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë dhe detyrat e tyre do të përcaktohen në Statutin e Shoqërisë.

Neni 9 Vula dhe të dhëna të tjera

Shoqëria do të ketë vulën e saj me madhësi të zakonshme, të dizenuar në formë rrethore me tekst për rreth saj emrin e shoqërisë dhe niptin përkatës. Shoqëria do të ketë edhe adresën e saj elektronike: ops@byachting.net.

Neni 10 Fuqia juridike

Ky akt themelimi është përpiluar dhe nënshkruan në gjuhën shqipe, në disa kopje dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga themeluesi dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESI
Edvin Bixha
